LIGJ
Nr.9334, datë 16.12.2004

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN E KIOTOS TË KONVENTËS KUADËR TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja "b" të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin e Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4445, datë 10.1.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

PROTOKOLLI I KIOTOS
PËR KONVENTËN KUADËR TË KOMBEVE TË BASHKUARA
PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Palët në këtë protokoll,

duke qenë palë të Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike, në vijim e përmendur si "Konventa",

në zbatim të objektivit final të Konventës, i deklaruar në nenin 2 të saj,

duke kujtuar dispozitat e Konventës,

të udhëhequr nga neni 3 i Konventës,

në zbatim të Mandatit të Berlinit të miratuar nga vendimi 1/CP.1 i Konferencës së Palëve në sesionin e parë të saj,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Për qëllimet e këtij Protokolli, do të aplikohen përkufizimet që përfshihen në nenin 1 të Konventës. Përveç kësaj:

1. "Konferencë e Palëve" nënkupton Konferencën e Shteteve Palë të Konventës.
2. "Konventë" nënkupton Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike, të miratuar në Nju-Jork në datën 9 maj 1992.
3. "Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike" nënkupton Panelin Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike të krijuar në vitin 1988 bashkërisht nga Organizata Botërore e Metereologjisë dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin.
4. "Protokolli i Montrealit" nënkupton Protokollin e Montrealit mbi substancat që pakësojnë shtresën e ozonit, miratuar në Montreal më 16 shtator 1987, i përshtatur dhe i ndryshuar më vonë.
5. "Palët e pranishme dhe votuese", nënkupton palët e pranishme dhe që japin një votë

pozitive ose negative.

6. “Palë” nënkupton një palë të këtij Protokolli, përjashtuar rastet kur konteksti është i ndryshëm.

7. “Palë e përfshirë në aneksin I” nënkupton një palë që përfshihet në aneksin I të Konventës, i cili mund të ndryshohet, ose një palë e cila ka bërë një njoftim në bazë të nenit 4 paragrafi 2(g) i Konventës.

Neni 2

1. Me qëllim që të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe në përmbushjen e angazhimeve për kufizimin dhe reduktimin e emetimeve në bazë të nenit 3, secila nga palët e përfshira në aneksin I:

a) do të zbatojnë dhe/ose përpunojnë politika dhe masa të mëtejshme në përputhje me rrethanat e tyre kombëtare, siç janë:

(i) rritja e efektivitetit të energjisë në sektorët përkatës të ekonomisë kombëtare;

(ii) mbrojtja dhe përmirësimi i baseneve dhe rezervuarëve të gazeve që shkaktojnë efektin serrë të cilat nuk kontrollohen nga Protokolli i Montrealit, duke pasur parasysh angazhimet e tyre në kuadrin e marrëveshjeve përkatëse në fushën e mjedisit; nxitjen e praktikave për administrimin e qëndrueshëm të pyjeve, pyllëzimin dhe ripyllëzimin;

(iii) nxitja e formave të qëndrueshme të bujqësisë duke pasur parasysh vlerësimet rreth ndryshimeve klimatike;

(iv) kërkimi dhe nxitja, zhvillimi dhe rritja e përdorimit të formave të reja dhe të rinovueshme të energjisë, të teknologjive të eliminimit të dioksidit të karbonit dhe të teknologjive pozitive të përparuara dhe novatore në drejtim të mjedisit;

(v) reduktimi progresiv ose mospërdorimi gradual i mallrave të papërshtatshme, stimuluesve fiskalë, përjashtimet nga taksat dhe tatimet dhe subvencionimet në të gjithë sektorët që emetojnë gaz që shkakton efektin serrë, të cilat veprojnë në kundërshtim me objektivat e Konventës dhe aplikimin e instrumenteve të tregut;

(vi) inkurajimi i reformave të përshtatshme në sektorët përkatës që synojnë nxitjen e politikave dhe masave që kufizojnë ose reduktojnë emetimin e gazeve që shkaktojnë efektin serrë dhe që nuk kontrollohen nga Protokolli i Montrealit;

(vii) masat që kufizojnë dhe/ose reduktojnë emetimet e gazeve që shkaktojnë efektin serrë që nuk kontrollohen nga Protokolli i Montrealit në sektorin e transportit;

(viii) kufizimi dhe/ose reduktimi i emetimeve të metanit nëpërmjet asgjësimit dhe përdorimit të shfrytëzimit të mbetjeve, si dhe në prodhimin, transportin dhe shpërndarjen e energjisë;

(ix) bashkëpunimi me shtetet e tjera palë për të rritur efektivitetin individual dhe të kombinuar të politikave dhe masave të tyre të miratuara në bazë të këtij neni, në mbështetje të nenit 4 paragrafi 2 (e)(i) të Konventës. Për pasojë, këto palë duhet të marrin masat për të dhënë eksperiencën e tyre dhe të shkëmbejnë informacion në lidhje me këto politika dhe masa, përfshirë mënyrat e zhvillimit të përmirësimit të krahasimit, transparencës dhe efektivitetit të tyre. Konferenca e Palëve, e cila shërben si një takim i palëve të këtij Protokolli, në sesionin e saj të parë ose sa më shpejt që të jetë e mundur pas saj, do të marrë në konsideratë mënyrat e lehtësimit të këtij bashkëpunimi, duke pasur parasysh të gjithë informacionin e nevojshëm.

2. Palët e përfshira në aneksin I duhet të zbatojnë kufizimin ose reduktimin e emisioneve të gazeve që shkaktojnë efektin serrë, që nuk kontrollohen nga Protokolli i Montrealit, nga cisternat e karburantit të aviacionit dhe marinës, që mbulohen respektivisht nga Organizata e Aviacionit Civil Ndërkombëtar dhe Organizata Ndërkombëtare e Detarisë.

3. Palët e përfshira në aneksin I do të përpiqen për të zbatuar masat dhe politikat në bazë të këtij neni në një mënyrë të tillë që të minimizojë efektet e kundërta, përfshirë efektet e kundërta të ndryshimeve klimatike, efektet e tregtisë ndërkombëtare dhe ndikimet sociale, mjedisore dhe ekonomike ndaj palëve të tjera dhe veçanërisht ato të identifikuara në nenin 4 paragrafi 8 dhe 9 të Konventës. Konferenca e Palëve, e cila shërben si takim i palëve të këtij Protokolli, mund të ndërmarrë, kur është e nevojshme, veprime të mëtejshme për të nxitur zbatimin e dispozitave të këtij paragrafi.

4. Konferenca e Palëve që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli, në qoftë se vendos se do të ishte i dobishëm koordinimi i çdonjërës prej politikave dhe masave të paragrafit 1(a) më lart,

duke marrë parasysh rrethanat e ndryshme kombëtare dhe efektet potenciale, do të marrë në konsideratë mënyrat dhe mjetet për shtjellimin e koordinimit të këtyre politikave dhe masave.

Neni 3

1. Palët e përfshira në aneksin I, individualisht ose bashkërisht, do të sigurojnë që emetimet ekuivalente të agregatëve antropogjenikë të dioksidit të karbonit të gazeve që shkaktojnë efektin serrë, të listuara në aneksin A, nuk do të kalojnë sasitë e tyre të paracaktuara, të llogaritura në përputhje me kufizimet sasiore të emetimeve dhe angazhimet e reduktimit të përshkruara në aneksin B dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni, me qëllim reduktimin e emetimeve të përgjithshme të këtyre gazeve të paktën 5% nën nivelet e vitit 1990 në periudhën e angazhimit 2008-2012.

2. Deri në vitin 2005, secila prej palëve të përfshira në aneksin I do të ketë bërë progres të dukshëm në arritjen e angazhimeve të saj në bazë të këtij Protokolli.

3. Ndryshimet në emetimet e gazeve që shkaktojnë efektin serrë nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve që rezultojnë nga ndryshimi i aktiviteteve të njeriut në ndryshimin e përdorimit të tokës dhe aktiviteteve në pyje që nga 1990, të matura si ndryshime të verifikueshme në stoqet e karbonit për secilën periudhë angazhimi, do të përdoret për të përmbushur angazhimet në bazë të këtij neni të secilës prej palëve të përfshira në aneksin I. Emetimet e gazit që shkaktojnë efektin serrë nga burimet dhe mbetjet e baseneve të shoqëruara me këto aktivitete do të raportohen në një mënyrë transparente dhe të verifikueshme dhe do të rishikohen në përputhje me nenet 7 dhe 8.

4. Përpara sesionit të parë të Konferencës së Palëve, që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli, secila palë e përfshirë në aneksin I do t'i sigurojë të dhëna për vlerësim Organit Ndihmës për Këshillime Shkencore dhe Teknologjike, me qëllim për të përcaktuar nivelin e tij të stoqeve të karbonit në vitin 1990 dhe për të siguruar përllogaritjen që do të arrihet nga ndryshimet në stoqet e karbonit në vitet pasuese. Konferenca e Palëve që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli, në sesionin e parë të saj ose sa më shpejt që të jetë e mundur më pas, do të vendosë për modalitetet, rregullat dhe orientimet lidhur me çështjen se si dhe cilat aktivitete shtesë të kryera nga dora e njeriut, që lidhen me ndryshimet në emetimet e gazit që shkakton efektin serrë nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve të baseneve në dherat bujqësore dhe në ndryshimin e shfrytëzimit të tokës dhe kategoritë e pyjeve, do të shtohet ose të hiqen nga sasitë e përcaktuara për palët e përfshira në aneksin I, duke pasur parasysh paqartësitë, transparencën në raportim, verifikueshmërinë dhe punën metodologjike të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, asistencën e dhënë nga Organi Ndihmës Këshillimor për Shkencën dhe Teknologjinë në përputhje me nenin 5 dhe vendimet e Konferencës së Palëve. Një vendim i tillë do të aplikohet në periudhën e dytë dhe në periudhat e mëvonshme të angazhimit. Një palë mund të zgjedhë për të aplikuar një vendim të tillë përsa i përket aktiviteteve shtesë të kryera nga dora e njeriut për periudhën e saj të parë të angazhimit, me kusht që këto aktivitete të jenë kryer që nga viti 1990.

5. Palët e përfshira në aneksin I, që janë në procesin e transicionit në ekonominë e tregut, viti bazë ose periudha e të cilave është vendosur në zbatim të vendimit 9/CP.2 të Konferencës së Palëve në sesionin e dytë të saj, do të shfrytëzojnë atë vit ose periudhë bazë për zbatimin e angazhimeve të tyre në bazë të këtij neni. Çdo palë tjetër e përfshirë në aneksin I, që është në procesin e transicionit drejt ekonomisë së tregut, e cila nuk ka dorëzuar ende komunikimin e saj të parë kombëtar në bazë të nenit 12 të Konventës, mund të njoftojë gjithashtu Konferencën e Palëve që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli dhe që synon të shfrytëzojë një vit ose periudhë historike bazë të ndryshme nga viti 1990 për zbatimin e angazhimeve në bazë të këtij neni. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli, do të vendosë mbi pranimin e një njoftimi të tillë.

6. Duke marrë në konsideratë nenin 4 paragrafi 6 i Konventës, në zbatimin e angazhimeve të tyre në bazë të këtij Protokolli, përveç atyre në bazë të këtij neni, do të lejohet një shkallë e caktuar fleksibiliteti nga Konferenca e Palëve që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli të palëve të përfshira në aneksin I që janë në rrugën e transicionit drejt ekonomisë së tregut.

7. Në periudhën e parë të angazhimit për kufizimin dhe reduktimin e emetimit sasior, nga viti 2008 deri në vitin 2012, sasia e caktuar për secilën palë të përfshirë në aneksin I do të jetë e barabartë me përqindjen e parashikuar për të në aneksin B të shumës së përgjithshme të emetimeve ekuivalente të dioksidit të karbonit antropogjenik të gazeve që shkaktojnë efektin serrë, të listuara në aneksin A në vitin 1990, ose në vitin ose periudhën bazë të përcaktuar në përputhje me paragrafin 5 më lart,

shumëzuar me pesë. Këto palë të përfshira në aneksin I, për të cilat ndryshimi i tokës së përdorshme dhe pyjet përbënin një burim të mbetur në emetimin e gazeve që shkaktojnë efektin serrë në vitin 1990, do të përfshijnë në emetimet e tyre të vitit ose periudhës bazë të vitit 1990 të shumës së përgjithshme të emetimeve ekuivalente të dioksidit të karbonit antropogjenik nga burimet minus mbetjet nga basenet në vitin 1990 nga ndryshimi i tokës së përdorur për qëllimet e llogaritjes së sasisë së caktuar për ta.

8. Secila palë e përfshirë në aneksin I mund të përdorë vitin 1995 si vitin e saj bazë për hidrofluorokarburet, perfluorokarburet dhe sulfur hekzafluoridet, për qëllimet e përllogaritjes së përmendur në nenin 7 të mësipërm.

9. Angazhimet për periudhat e mëvonëshme për palët e përfshira në aneksin I, do të vendosen në ndryshimet që do t'i bëhen aneksit B të këtij Protokolli, të cilat do të miratohen në përputhje me dispozitat e nenit 21 paragrafi 7. Konferenca e shteteve palë që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli do të iniciojë shqyrtimin e këtyre angazhimeve të paktën shtatë vjet para mbarimit të periudhes së parë të angazhimit të përmendur në paragrafin 1 të mësipërm.

10. Çdo njësi e reduktimit të emetimit, ose çdo pjesë e një sasie të përcaktuar, të cilën një palë e transferon në një palë tjetër në përputhje me dispozitat e nenit 6 ose të nenit 17, do të shtohet në sasinë e caktuar për palën marrëse.

11. Çdo njësi e reduktimit të emetimit, ose çdo pjesë e një sasie të përcaktuar, të cilën një palë e transferon në një palë tjetër në përputhje me dispozitat e nenit 6 ose të nenit 17, do të zbritet nga sasia e përcaktuar për palën transferuese.

12. Çdo reduktim i zyrtarizuar i emetimeve, të cilën një palë e merr nga një tjetër palë në përputhje me dispozitat e nenit 12, do t'i shtohet sasisë së përcaktuar për palën marrëse.

13. Në qoftë se emetimet e një pale të përfshirë në aneksin I në një periudhë angazhimi janë më të pakta sesa sasia e caktuar për të në bazë të këtij neni, kjo diferencë, me kërkesën e asaj pale, do të shtohet në sasinë e caktuar për atë palë për periudhat e mëvonshme të angazhimit.

14. Secila palë e përfshirë në aneksin I duhet të përpiqet të përmbushë angazhimet e përmendura në paragrafin 1 më sipër, në mënyrë të tillë që të minimizojë ndikimet e padëshirueshme sociale, ekonomike, si dhe ato të mjedisit mbi palët e vendeve në zhvillim, veçanërisht ato të identifikuara në nenin 4 paragrafët 8 dhe 9 të Konventës. Në përputhje me vendimet përkatëse të Konferencës mbi zbatimin e atyre paragrafëve, Konferenca që shërben si mbledhje e palëve për këtë Protokoll, në seancën e parë duhet të konsiderojë marrjen e vendimeve që janë të nevojshme për minimizimin e pasojave të padëshirueshme në ndryshimin e klimës dhe/ose ndikimet si rrjedhojë e hapave të marra nga palët e përmendura në ato paragrafë. Ndër çështjet për t'u konsideruar do të jenë vendosja e fondeve, sigurimi dhe trasferimi i teknologjisë.

Neni 4

1. Palët e përfshira në aneksin I, të cilat kanë arritur një marrëveshje për të përmbushur së bashku angazhimet sipas nenit 3, do të konsiderohen se kanë përmbushur këto angazhimeve duke u siguruar që shuma e përgjithshme e karbonit dioksid antropogjenik, ekuivalent me emetimin e gazeve që shkatojnë efektin serrë të renditura në aneksin A, nuk do të kalojnë sasitë e përcaktuara, të llogaritura në përputhje me emetimin e tyre të limituar dhe me angazhimet për t'i pakësuar, të përshkruara në aneksin B në përputhje me dispozitat e nenit 3. Niveli përkatës i emetimit i lejuar për secilën palë në marrëveshje duhet të përcaktohet në atë marrëveshje.

2. Palët e një marrëveshjeje të tillë do të njoftojnë sekretariatin për kushtet e marrëveshjes në datën e dorëzimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit të këtij Protokolli ose aderimit në të. Sekretariati nga ana tij do të informojë palët dhe nënshkruesit e Konventës mbi kushtet e marrëveshjes.

3. Çdo marrëveshje e tillë do të qëndrojë në zbatim për kohëzgjatjen e periudhës së angazhimit specifikuar në nenin 3 paragrafi 7.

4. Në qoftë se palët veprojnë në këtë mënyrë bashkërisht brenda kuadrit dhe në bashkëpunim me një organizatë rajonale të integrimit ekonomik, çdo ndryshim në përbërjen e organizatës pas miratimit të këtij Protokolli nuk do të ndikojë në angazhimet ekzistuese sipas këtij Protokolli. Çdo ndryshim në përbërjen e organizatës zbatohet vetëm për qëllimet e atyre angazhimeve sipas nenit 3, të miratuara mbas atij ndryshimi.

5. Në rast të dështimit të palëve, në marrëveshje për të arritur shumën totale të nivelit të uljes të emetimit, secila palë e marrëveshjes do të jetë përgjegjëse për nivelin personal të emetimit të caktuar në marrëveshje.

6. Në qoftë se palët veprojnë së bashku brenda kuadrit dhe në bashkëpunim me një organizatë rajonale të integrimit ekonomik, e cila është vetë palë e Protokollit, çdo shtet anëtar i asaj organizate rajonale të integrimit ekonomik, në mënyrë individuale dhe së bashku me organizatën rajonale të integrimit ekonomik që vepron në përputhje me nenin 24, në rast dështimi për të përmbushur shumën totale të nivelit të uljes të emetimit, janë përgjegjës për nivelin e tyre të emetimit të caktuar në përputhje me këtë nen.

Neni 5

1. Palët e përfshira në aneksin I do të caktojnë, jo më vonë se një vit përpara fillimit të periudhës së parë angazhuese, një sistem kombëtar për vlerësimin e emetimeve antropogjenike nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve në basene të të gjitha gazeve që shkaktojnë efektin serrë të cilat nuk janë të kontrolluara nga Protokolli Montrealit. Udhëzimet për sisteme kombëtare të tilla, të cilat do të përfshijnë metodologjitë e përfshira në paragrafin 2 më poshtë, do të vendosen nga Konferenca e Palëve e cila shërben si mbledhje për palët në këtë Protokoll në seancën e parë.

2. Metodologjia për vlerësimin e emetimit antropogjenik nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve të gjitha gazeve të efektit serrë të cilat nuk janë të kontrolluara nga Portokolli i Montrealit do të jenë ato të pranuara nga Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, rënë dakord nga Konferenca e Palëve në sesionin e tretë të saj. Aty ku këto metodologji nuk janë përdorur, do të aplikohen modifikime të përshtatshme sipas metodologjive të përcaktuara nga Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje për palët në këtë Protokoll në sesionin e parë. Bazuar mbi punën, *inter alia*, Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, si dhe këshillat e dhëna nga Trupi Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik, Konferenca e Palëve që shërben si takim për palët e këtij Protokolli, duhet rregullisht të kontrollojë dhe, ku është e përshtatshme, të rishikojë të tilla metodologji dhe rregullime, duke marrë plotësisht parasysh çdo vendim përkatës nga Konferenca e Palëve. Çdo rishikim i metodologjive dhe rregullimeve duhet të përdoret vetëm për qëllime të cilat sigurojnë përputhshmërinë me angazhimet sipas nenit 3 në lidhje me çdo periudhë angazhimi të miratuar pas atij rishikimi.

3. Potencialet e ngrohjes globale, përdorur për të llogaritur ekuivalentin e dioksidit të karbonit me atë të emetimit antropogjenik nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve të gazeve të efektit serrë të përmendura në aneksin A, do të jenë ato të pranuara nga një Panel Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike dhe të rëna dakord nga Konferenca e Palëve në seancën e tretë. Bazuar mbi punën, *inter alia*, Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike dhe këshillat e dhëna nga Trupi Ndihmës për Këshilla Shkencore dhe Teknologjike, Konferenca e Palëve shërben si mbledhje e Palëve në Protokoll, do të rishikojë rregullisht dhe ku është e përshtatshme të rishikojë potencialin e ngrohjes globale të secilit prej këtyre gazeve të efektit serrë, duke pasur parasysh vendimet përkatëse të Konferencës së Palëve. Çdo rishikim i potencialit të ngrohjes globale do të aplikohet vetëm ndaj angazhimeve sipas nenit 3 duke respektuar çdo periudhë angazhimi të miratuar pas këtij rishikimi.

Neni 6

1. Me qëllim që të përmbushë detyrimet sipas nenit 3, çdo palë e përfshirë në aneksin I mund të transferojë në, apo marrë nga, çdo palë tjetër njësitë e zvogëlimit të emetimit që rezultojnë nga projekte të cilat mund të ulin emetimet antropogjenike nga burimet apo për të rritur emetimet antropogjenike nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve në çdo sektor të ekonomisë, me kusht që:

a) çdo projekt i tillë ka miratimin e palëve të përfshira;

b) çdo projekt i tillë siguron një ulje të emetimeve nga burime ose një intensifikim të mbetjeve nëpërmjet baseneve, përveç asaj që do të ndodhte në rastin e kundërt;

c) nuk përfiton ndonjë njësi të zvogëlimit të emetimit në qoftë se nuk është në përputhje me detyrimet e kërkuara sipas nenit 5 dhe 7; dhe

d) sigurimi i njësive të zvogëlimit të emetimit do të jetë plotësues i aktiviteteve të brendshme me qëllim për të arritur angazhimet sipas nenit 3.

2. Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli, në sesionin e parë apo sa më parë të mundet dhe të jetë e praktikueshme më pas, mund të zhvillojnë më tej udhëzimet për zbatimin e këtij neni, përfshirë verifikimin dhe raportimin.

3. Një palë e përfshirë në aneksin I mund të autorizojë persona juridikë për të marrë pjesë, nën përkujdesjen e saj, në veprimet që çojnë në gjenerimin, transferimin apo përvetësimin sipas këtij neni të njësive të zvoglimit të emetimit.

4. Në qoftë se një problem, gjatë zbatimit nga një palë e përfshirë në aneksin I nga kërkesat e përmendura në këtë nen, identifikohet në përputhje me klauzolat përkatëse të nenit 8, transfertat dhe përvetësimi i njësive të uljes së emetimit mund të vazhdojë të bëhet pasi çështja është identifikuar, me kusht që çdo njësi e tillë të mos përdoret nga palët për të përmbushur angazhimet sipas nenit 3, derisa çeshtja e përputhmërisë të zgjidhet.

Neni 7

1. Secila palë e përfshirë në aneksin I duhet të përfshijë në inventarin vjetor të emetimeve antropogjenike, nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve të gazeve të efektit serrë të pakontrolluara nga Protokolli i Montrealit, të dorëzuara në përputhje me vendimet përkatëse të Konferencës së Palëve, informacionin e duhur shtesë për të siguruar pajtimin me nenin 3, për t'u caktuar në përputhje me paragrafin 4, më poshtë.

2. Secila palë e përfshirë në aneksin I duhet të përfshijë në komunikimin kombëtar, të dorëzuar sipas nenit 12 të Konventës, informacion të nevojshëm dhe plotësues për të treguar përputhshmërinë me angazhimet sipas këtij Protokolli, për t'u vendosur në përputhje me paragrafin 4 më poshtë.

3. Çdo palë e përfshirë në aneksin I duhet të dorëzojë informacionin e kërkuar sipas paragrafit 1 më lart, duke filluar nga inventari i parë i kërkuar nga Konventa për vitin e parë të periudhës së angazhimit pasi Protokolli ka hyrë në fuqi për atë palë. Çdo palë e tillë duhet të dorëzojë informacionin e kërkuar sipas paragrafit 2 më sipër, si pjesë e komunikimit të parë nacional të kërkuar nga Konventa pasi ky Protokoll ka hyrë në fuqi për të dhe pas miratimit të udhëzimeve të dhëna në paragrafin 4 më poshtë. Frekuenca e paraqitjes së mëtejshme të informacionit të kërkuar nga ky nen do të përcaktohet nga Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, duke marrë parasysh kohët e përcaktuara për dorëzimin e komunikimeve kombëtare të përcaktuar nga Konferenca e Palëve.

4. Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli do të miratojë gjatë seancës së parë dhe do rishikojnë në mënyrë periodike më pas udhëzimet për përgatitjen e informacionit të kërkuar sipas këtij neni, duke marrë parasysh udhëzimet për përgatitjen e komunikimeve kombëtare nga palët të përfshira në aneksin I, miratuar nga Konferenca e Palëve. Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli, gjithashtu, para periudhës fillestare të angazhimit, do të përcaktojë modalitetet për llogaritjen e shumave të caktuara.

Neni 8

1. Informacioni i dorëzuar sipas nenit 7 nga secila palë e përfshirë në aneksin I do të rishikohet nga grupe eksperte, në përputhje me vendimet përkatëse të Konferencës së Palëve dhe në përputhje me udhëzimet e miratuara për këtë qëllim nga Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli sipas paragrafit 4 më poshtë. Informacioni i dorëzuar sipas nenit 7 paragrafi 1, nga secila Palë e përfshirë në aneksin I, do të rishikohet si pjesë e përpilimit dhe llogaritjeve vjetore të inventarit të emetimeve dhe shumave të caktuara. Gjithashtu, informacioni i dorëzuar sipas nenit 7 paragrafi 2, nga secila palë e përfshirë në aneksin I, do të rishikohet si pjesë e rivlerësimit të komunikimeve.

2. Grupet eksperte të shqyrtimit do të koordinohen nga sekretariati dhe do të përbëhen nga ekspertë të përzgjedhur prej atyre të emëruar nga palët e Konventës dhe, ku është e përshtatshme, nga shoqata ndërqeveritare, në përputhje me direktivat e dhëna për këtë qëllim nga Konferenca e Palëve.

3. Procesi i shqyrtimit do të japë një vlerësim teknik të plotë dhe të gjithanshëm të të gjitha aspekteve të zbatimit nga një palë e këtij Protokolli. Grupet eksperte të shqyrtimit do të përgatisin një raport të Konferencës së Palëve, që shërben si mbledhje e palëve në këtë Protokoll, duke vlerësuar

zbatimin e angazhimeve të palëve dhe duke identifikuar çdo potencial për problem në, dhe në faktorët që ndikojnë plotësimin e angazhimeve. Këto raporte do të qarkullojnë nga sekretariati te të gjitha palët e Konventës. Sekretariati do të shënojë ato pyetje të zbatimit të treguara në këto raporte për shqyrtim të mëtejshëm nga Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje për palët në këtë Protokoll.

4. Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli, do të miratojë gjatë seancës së parë dhe do të rishikojë në mënyrë periodike më tej udhëzimet për rishikimin e zbatimit të Protokollit nga grupet eksperte të shqyrtimit duke marrë parasysh vendimet përkatëse të Konferencës së Palëve.

5. Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje për Palët e këtij Protokolli, me ndihmën e Organit Ndihmës për Zbatimin dhe të Organit Ndihmës për Këshilla Shkencorë dhe Teknologjikë, kur është e përshtatshme, do të shqyrtojë:

a) informacionin e dorëzuar nga palët sipas nenit 7 dhe raportet e rishikimeve te ekspertëve të kryera sipas këtij neni; dhe

b) çështjet mbi zbatimin, të shënuara nga sekretariati sipas paragrafit 3 më sipër, si dhe çështjet e ngritura nga palët.

6. Në përputhje me shqyrtimin e informacionit të përmendur në paragrafin 5 më lart, Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje për palët në këtë Protokoll, do të marrë vendime në çdo çështje të kërkuar për zbatimin e Protokollit.

Neni 9

1. Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli, do të rishikojë periodikisht këtë Protokoll, duke marrë parasysh informacionin shkencor më të mirë dhe të disponueshëm dhe vlerësimet mbi ndryshimet klimatike dhe rrjedhojat e saj, si dhe informacionet teknike, sociale dhe ekonomike të cilat kanë lidhje me çështjen. Këto rishikime do të koordinohen me rishikimet përkatëse sipas Konventës, në veçanti me ato të kërkuara nga neni 4 paragrafi 2 (d) dhe neni 7 paragrafi 2 (a) i Konventës. Duke u bazuar mbi këto rishikime, Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli do të marrë masat e duhura.

2. Rishikimi i parë do të zhvillohet në seancën e dytë të Konferencës së Palëve, e cila shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli. Rishikimet e mëpasshme do të zhvillohen në intervale të rregullta në kohë të caktuara.

Neni 10

Të gjitha palët, duke marrë parasysh detyrat e përbashkëta por njëkohësisht të diferencuara, si dhe prioritetet e tyre specifike të zhvillimit kombëtar dhe rajonal, objektivat dhe rrethanat, pa paraqitur angazhime të reja për palët të cilat nuk janë të përfshira në aneksin I, por rimiratojnë angazhimet ekzistuese sipas nenit 4 paragrafi 1 të Konventës dhe vazhdojnë të përparojnë në zbatimin e këtyre angazhimeve në mënyrë të tillë që të arrijnë zhvillim të qëndrueshëm, duke marrë parasysh nenin 4 paragrafët 3, 5 dhe 7 të Konventës:

a) duhet të formulojnë, aty ku është e mundur dhe e përshtatshme, programe me kosto efektive kombëtare dhe rajonale për të përmirësuar cilësinë e faktorëve të emetimeve vendore, të dhënat e aktiviteteve dhe/ose modele, të cilat reflektojnë kushtet sociale dhe ekonomike të secilës palë për përgatitjen dhe përmirësimin periodik të inventarit kombëtar të emetimeve antropogjenike nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve të të gjitha gazeve që shkaktojnë efektin serrë të pakontrolluara nga Protokolli i Montrealit, duke përdorur metodologji të krahasueshme, për të cilat duhet të vendoset në Konferencën e Palëve dhe në përputhje me udhëzimet për përgatitjen e njoftimeve kombëtare të miratuara nga Konferenca e shteteve palë;

b) duhet të formulojnë, zbatojnë, publikojnë dhe të rinovojnë rregullisht programet kombëtare dhe, aty ku është e përshtatshme, programet rajonale të cilat përfshijnë masa për përmirësimin e ndryshimeve klimatike, si dhe masa për lehtësimin e përshtatjes sa më të mirë me ndryshimet klimatike:

i) Këto programe mund të ndërmerren, ndër të tjera, në fushën e energjisë, transportit dhe sektorëve të industrisë, si dhe në bujqësi, pyje dhe administrimin e mbetjeve. Gjithashtu, teknologjitë e përshtatjes dhe metodat për përmirësimin e planifikimit hapësinor mund të përmirësojnë përshtatjen në

lidhje me ndryshimet klimatike; dhe

ii) Palët e përfshira në aneksin I do të japin informacione, duke përfshirë programet kombëtare mbi masat e marra në përputhje me nenin 7 të këtij Protokolli; dhe shtetet e tjera palë do të përpiqen të përfshijnë në komunikimet e tyre kombëtare, aty ku është e përshtatshme, informacion mbi programet që përmbajnë masa, të cilat sipas shteteve palë, kontribuojnë në adresimin e problemeve në lidhje me ndryshimet klimatike dhe ndikimeve të saj të padëshiruara, duke përfshirë uljen e rritjes së emetimit të gazeve që ndikojnë në efektin serrë, si dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve dhe zgjerimin e ngritjen e kapaciteteve dhe masave përshtatëse.

c) duhet të bashkëpunojnë në nxitjen e mënyrave efektive për zhvillimin, zbatimin dhe shpërndarjen e teknologjive të ndjeshme për mjedisin, njohurive, praktikave dhe proceseve në lidhje me ndryshimet klimatike në veçanti për vendet në zhvillim, si dhe të ndërmarrin të gjitha hapat praktike për nxitjen, lehtësimin, financimin, transferimin ose mundësimin e teknologjive të mësipërme, duke përfshirë formulimin e politikave dhe programeve për transferimin e teknologjive mjedisore të ndjeshme të cilat ndodhen në pronësi publike ose në fusha publike dhe krijimin e mundësive për sektorin privat në drejtim të nxitjes, zgjerimit, transferimit dhe aksesit në teknologjitë e ndjeshme për mjedisin;

d) duhet të bashkëpunojnë në kërkimet shkencore dhe teknike dhe të nxisin mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve sistematike të vëzhgimit, si dhe zhvillimin e bazave të të dhënave për minimizimin e paqartësive që lidhen me sistemin klimatik, ndikimet e padëshiruara në ndryshimet klimatike dhe pasojat ekonomike dhe sociale të strategjive të ndryshme për këtë qëllim, si dhe nxitjen e zhvillimit dhe forcimin e kapaciteteve dhe aftësive të mirëfillta për të marrë pjesë në përpjekjet, programet dhe rrjetet ndërkombëtare dhe ndërqeveritare mbi kërkimet dhe vëzhgimin sistematik, duke mbajtur parasysh nenin 5 të Konventës;

e) duhet të bashkëpunojnë në nxitjen e zhvillimin dhe zbatimin e programeve të arsimimit dhe trajnimit në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve kombëtare, në veçanti kapacitetet njerëzore dhe institucionale dhe shkëmbimin e personelit për të trajnuar ekspertë në këtë fushë, në veçanti për vendet e zhvilluara dhe lehtësimin e informacionit për publikun në nivel kombëtar mbi ndryshimet klimatike, duke përdorur organet ekzistuese aty ku kjo gjë paraqitet e përshtatshme. Nëpërmjet organeve përkatëse të Konventës duhet të zhvillohen modalitete të përshtatshme për zbatimin e këtyre aktiviteteve, duke marrë parasysh nenin 6 të Konventës;

f) duhet të përfshijnë në komunikimet e tyre kombëtare informacion mbi programet dhe aktivitetet e ndërmarra sipas këtij neni, në përputhje me vendimet përkatëse të Konferencës së shteteve palë; dhe

g) duhet të marrin parasysh nenin 4 paragrafi 8 i Konventës në zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga ky nen.

Neni 11

1. Në zbatimin e nenit 10, palët duhet të mbajnë parasysh dispozitat e nenit 4 paragrafët 4, 5, 7, 8 dhe 9 të Konventës.

2. Në kontekstin e zbatimit të nenit 4 paragrafi 1 i Konventës, në përputhje me dispozitat e nenit 4 paragrafi 3 dhe nenit 11 të Konventës, si dhe nëpërmjet organit apo organeve të cilave u janë besuar veprimi me mekanizmat financiarë të Konventës, shtetet palë të zhvilluara dhe palët e tjera të zhvilluara të përfshira në aneksin II të Konventës:

a) do të sigurojnë burime financiare të reja dhe shtesë për arritjen e kostos së plotë që nevojitet për shtetet palë në zhvillim, në zbatimin e angazhimeve ekzistuese sipas nenit 4 paragrafi 1(a) të Konventës që mbulohet nga neni 10 nënparagrafi (a); dhe

b) gjithashtu do të sigurojnë burime të tilla financiare, duke përfshirë edhe ato që i nevojiten shteteve palë në zhvillim për transferimin e teknologjisë, me qëllim arritjen e kostos së plotë të shtuar për të cilën është rënë dakord dhe zbatimin e angazhimeve ekzistuese sipas nenit 4 paragrafi 1 i Konventës, të cilat mbulohen nga neni 10, për të cilat është rënë dakord ndërmjet një shteti palë në zhvillim dhe organit apo organeve ndërkombëtare të cilave i referohet neni 11 i Konventës, në përputhje me atë nen.

Zbatimi i këtyre angazhimeve ekzistuese do të marrë parasysh nevojën për mjaftueshmërinë dhe parashikueshmërinë në rrjedhjen e fondeve dhe rëndësinë e ndarjes së barrës financiare në mënyrë

të përshtatshme ndërmjet shteteve palë të zhvilluara. Ndihma për organin apo organet e ngarkuara me veprimet e mekanizmave financiarë të Konventës në vendimet e Konferencës së Palëve, duke përfshirë edhe ato për të cilat është rënë dakord para miratimit të këtij Protokolli, do të zbatohen *mutatis mutandis* në dispozitat e këtij paragrafi.

3. Shtetet palë të zhvilluara dhe palët e tjera të zhvilluara në aneksin II të Konventës gjithashtu mund të sigurojnë burime financiare nëpërmjet kanaleve dypalëshe, rajonale apo shumëpalëshe për shtetet palë në zhvillim.

Neni 12

1. Një mekanizëm zhvillimi i pastër është përkufizuar në vijim.

2. Qëllimi i një mekanizmi të zhvillimit të pastër do të jetë që të ndihmojë palët të cilat nuk janë përfshirë në aneksin I në arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe kontributi për qëllimin final të Konventës, si dhe të ndihmojë palët e përfshira në aneksin I në arritjen e objektivave për kufizimet në emetimit të gazrave dhe angazhimet për zvogëlimin e tyre sipas nenit 3.

3. Sipas mekanizmit të zhvillimit të pastër:

a) palët që nuk janë përfshirë në aneksin I do të përfitojnë nga aktivitetet e projektit që do të rezultojnë në njohjen e certifikuar të reduktimit të emetimeve; dhe

b) palët e përfshira në aneksin I mund ta përdorin njohjen e certifikuar të reduktimit të emetimeve duke përfituar nga këto aktivitete të projektit, të cilat kontribuojnë në plotësimin e një pjese të detyrimeve të tyre për kufizimin e emetimit në përputhje me nenin 3, ashtu siç përcaktohet nga Konferenca e shteteve palë që shërben si mbledhje e shteteve palë të këtij Protokolli.

4. Mekanizmi i një zhvillimi të pastër do të drejtohet dhe administrohet nga Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli dhe do të mbikëqyret nga ana e një bordi ekzekutiv e mekanizmit të zhvillimit të pastër.

5. Kufizimet e emetimit që rezultojnë nga çdo aktivitet projekti, do të zyrtarizohen nga organe operacionale që caktohen nga Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhja e palëve të këtij Protokolli, mbi bazën e:

a) pjesëmarrjes vullnetare e miratuar nga të gjitha palët e përfshira;

b) përfitimeve të vërteta, të matshme dhe afatgjata që lidhen me përmirësimin e ndryshimeve klimatike; dhe

c) reduktimin të emetimeve të cilat ndodhin në të gjithë botën, në mungesë të një projekti të zyrtarizuar.

6. Mekanizmi i zhvillimit të pastër do të ndihmojë sipas nevojës në gjetjen e fondeve për aktivitetet në kuadrin e projekteve të zyrtarizuara.

7. Në mbledhjen e saj të parë, Konferenca e Palëve, e cila shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, do të përpunojë modalitetet dhe procedurat me qëllim sigurimin e transparencës, eficençës dhe dhënien e llogarisë nëpërmjet një kontrolli dhe verifikimi të pavarur të aktiviteteve në kuadër të projekteve.

8. Duke shërbyer si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, Konferenca e Palëve do të bëjë të mundur që një pjesë e përfitimit nga aktivitetet në kuadër të projekteve të zyrtarizuara të përdoret për mbulimin e shpenzimeve administrative, si dhe të ndihmojë shtetet palë në zhvillim, të cilat janë veçanërisht të ndjeshme nga efektet e dëmshme të ndryshimeve klimatike, për mbulimin e kostos së përshtatjes.

9. Pjesëmarrja në mekanizmin e zhvillimit të pastër, duke përfshirë edhe aktivitetet e përmendura në paragrafin e mësipërm 3(a), si dhe në arritjen e reduktimeve të zyrtarizuara të emetimit të gazit, mund të përfshijë subjekte private dhe/ose publike dhe drejtimi i tyre mund të sigurohet nga bordi ekzekutiv i mekanizmit të zhvillimit të pastër.

10. Reduktimet zyrtare të emetimit të arritura gjatë periudhës nga viti 2000 deri në fillimin e periudhës së parë të angazhimit mund të përdoren në arritjen e objektivave të periudhës së parë të angazhimit.

Neni 13

1. Konferenca e Palëve, organi më i lartë i Konventës, do të shërbejë edhe si mbledhje e

palëve të këtij Protokolli.

2. Palët e Konventës që nuk janë palë në këtë Protokoll, mund të marrin pjesë si vëzhgues në punimet e çdo sesioni të Konferencës së Palëve, që shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli. Kur Konferenca e Palëve shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, vendimet sipas këtij Protokolli do të merren vetëm nga palët e këtij Protokolli.

3. Kur Konferenca e Palëve shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, çdo anëtar i Byrosë së Konferencës së shteteve palë, të cilat përfaqësojnë një palë në Konventë, por që në të njëjtën kohë nuk janë palë e këtij Protokolli, do të zëvendësohen nga një anëtar shtesë, i cili zgjidhet nga/dhe ndërmjet palëve të këtij Protokolli.

4. Konferenca e Palëve, e cila shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, do të rishikojë rregullisht zbatimin e këtij Protokolli dhe do të marrë brenda kompetencave vendimet e nevojshme për nxitjen e zbatimit efektiv të tyre. Gjithashtu, ajo do të kryejë funksionet që i janë ngarkuar nga ky Protokoll dhe:

a) do të ndihmojë palët e Protokollit në zbatimin e Protokollit, mbi bazën e informacionit që merret në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli, për ndikimin e masave të përgjithshme të marra sipas këtij Protokolli, në veçanti efektet mjedisore, ekonomike dhe sociale, si dhe ndikimin e tyre kumulativ, si dhe masën e progresit që është arritur në drejtim të objektivave të Konventës;

b) do të shqyrtojë periodikisht detyrimet e palëve mbi bazën e Protokollit, duke i dhënë rëndësinë e duhur çdo rishikimi që parashikohet nga neni 4 paragrafi 2(d) dhe neni 7 paragrafi 2 i Konventës, në përputhje me objektivat e Konventës dhe eksperiencën e përfituar në zbatimin e saj, si dhe evoluimin e njohurive shkencore dhe teknike, duke miratuar rregullisht raporte mbi zbatimin e këtij Protokolli;

c) do të nxisë dhe do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit mbi masat e miratuara nga palët në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe efekteve të saj, duke marrë parasysh rrethanat e ndryshme, përgjegjësitë dhe aftësitë e shteteve palë, si dhe angazhimet e tyre respektive në bazë të këtij Protokolli;

d) do të lehtësojë, mbi bazën e kërkesës të dy ose më shumë palëve, koordinimin e masave të miratuara nga ata për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike dhe efekteve të saj, duke marrë parasysh rrethanat e ndryshme, përgjegjësitë dhe aftësitë e palëve, si dhe angazhimet e tyre respektive në bazë të këtij Protokolli;

e) do të nxisë dhe do të drejtojë, në përputhje me objektivat e Konventës dhe dispozitat e këtij Protokolli dhe duke marrë plotësisht parasysh vendimet e Konferencës së Palëve, zhvillimin dhe përmirësimin periodik të metodologjive të krahasueshme për zbatimin efektiv të këtij Protokolli, për të cilën do të bihet dakord nga Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli;

f) do të japë rekomandime mbi çdo çështje që është e nevojshme për zbatimin e këtij Protokolli;

g) do të vlerësojë mundësinë e angazhimit të burimeve financiare shtesë, në përputhje me nenin 11 paragrafi 2;

h) do të formojnë organet e duhura vartëse, të cilat konsiderohen të nevojshme për zbatimin e këtij Protokolli;

i) do të kërkojë dhe përdorë, aty ku është e nevojshme, shërbimet, bashkëpunimin dhe informacionin e siguruar nga organizatat kompetente ndërkombëtare, si dhe nga organet ndërqeveritare dhe joqeveritare; dhe

j) do të kryejë funksionet e tjera, sipas nevojës, për zbatimin e Protokollit, si dhe do të marrë parasysh çdo detyrë dalë nga një vendim i Konferencës së Palëve.

5. Rregullat e procedurës të Konferencës së Palëve dhe procedurat financiare që zbatohen mbi bazën e Konventës do të aplikohen *mutatis mutandis* mbi bazën e këtij Protokolli, përveç rasteve kur Konferenca e Palëve, e cila shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, vendos ndryshe me konsensus.

6. Sesioni i parë i Konferencës së Palëve, e cila shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, do të mblidhet nga sekretariati duke e kombinuar me sesionin e parë të Konferencës së Palëve e cila është vendosur të zhvillohet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Protokolli. Sesionet e zakonshme vijuese të Konferencës së Palëve, që shërbejnë edhe si mbledhje të palëve të këtij Protokolli, do të mbahen çdo vit në kombinim me sesionet e zakonshme të Konferencës së Palëve, nëse nuk vendoset ndryshe nga Konferenca e Palëve e cila shërben si mbledhje e Palëve të këtij

Protokolli.

7. Sesionet e jashtëzakonshme të Konferencës së Palëve, e cila shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, do të mbahen në kohën në të cilën ato konsiderohen të nevojshme nga Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, ose mbi bazën e një kërkese me shkrim nga çdo Palë dhe nëse 6 muaj nga njoftimi i kësaj kërkese nga ana e sekretariatit të palëve, kjo kërkesë merr mbështetjen e të paktën një të tretës së palëve.

8. Organizata e Kombeve të Bashkuara, agjencitë e saj të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare për Energjinë Atomike, si dhe çdo shtet zyrtarisht palë apo jo e Konventës mund të përfaqësohen si vëzhgues në sesionet e Konferencës së Palëve që shërben si mbledhje e palëve të Protokollit. Çdo organ apo agjenci kombëtare apo ndërkombëtare, qeveritare apo jo, e cila vepron në çështje të mbuluara nga ky Protokoll dhe që ka njoftuar sekretariatin për dëshirën e tij për t'u përfaqësuar në një sesion të Konferencës së Palëve, që shërben si takim i palëve të këtij Protokoll si një vëzhgues, mund të pranohet kështu, përveçse kur të paktën një e treta e palëve prezente është kundër. Pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve do të jetë objekt i rregullave të procedurës, siç referohet në paragrafin 5 më lart.

Neni 14

1. Sekretariati i ngritur sipas nenit 8 të Konventës do të shërbejë si sekretariat i këtij Protokolli.

2. Neni 8 paragrafi 2 i Konventës mbi funksionet e sekretariatit dhe neni 8 paragrafi 3 i Konventës mbi rregullimet e bëra për funksionimin e sekretariatit, do të zbatojë *mutatis mutandis* në këtë Protokoll. Sekretariati, si shtesë, do të ushtrojë funksionet e dhëna atij nën këtë Protokoll.

Neni 15

1. Organi Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organi Ndihmës për Zbatimin, të përcaktuar sipas neneve 9 dhe 10 të Konventës, do të shërbejnë, respektivisht, si Organ Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organ Ndihmës për Zbatimin e këtij Protokolli. Dispozitat e lidhura me funksionimin e këtyre dy organeve sipas Konventës do të aplikohen *mutatis mutandis* për këtë Protokoll. Sesionet e mbledhjeve të Organit Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organit Ndihmës për Zbatimin e këtij Protokolli do të mbahen njëkohësisht me mbledhjet, respektivisht, të Organit Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organit Ndihmës për Zbatimin e Konventës.

2. Palët në Konventë që nuk janë palë e këtij Protokolli, mund të marrin pjesë si vëzhgues në punimet e çdo sesioni të organeve ndihmëse. Kur organet ndihmëse shërbejnë si organe ndihmëse të këtij Protokolli, vendimet sipas këtij Protokolli do të merren vetëm nga ata që janë palë të tij.

3. Kur organet e ndërvarura të krijuara nga nenet 9 dhe 10 të Konventës ushtrojnë funksionet e tyre në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me këtë Protokoll, çdo anëtar i Byrosë i atyre organeve të ndërvarura që përfaqëson një palë të Konventës, por në atë kohë, nuk është palë e këtij Protokolli, do të zëvendësohet nga një anëtar shtesë, që do të zgjidhet nga dhe ndërmjet palëve të këtij Protokolli.

Neni 16

Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, do të shqyrtojë, sa më shpejt praktikisht, zbatimin e këtij Protokolli dhe do të modifikojë sipas mënyrës më të përshtatshme, procesin konsultativ shumëpalësh referuar nenit 13 të Konventës, në dritën e çdo vendimi përkatës që mund të merret nga Konferenca e Palëve. Çdo proces konsultativ shumëpalësh që mund të zbatohet në këtë Protokoll do të veprojë pa paragjykim në procedurat dhe mekanizmat e vendosura në përputhje me nenin 18.

Neni 17

Konferenca e Palëve, do të përcaktojë parimet, modalitetet, rregullat dhe udhëzimet përkatëse për verifikim, raportim dhe përgjegjësi për emetimet tregtare. Palët e përfshira në aneksin B mund të

marrin pjesë në emetimet tregtare për qëllimet e përmbushjes së angazhimeve të tyre sipas nenit 3. Çdo tregti e tillë do të jetë shtojcë e veprimeve të brendshme me qëllim plotësimin e kufizimit të emetimeve sasiore dhe angazhimeve reduktuese sipas atij neni.

Neni 18

Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, në sesionin e parë do të miratojë procedura dhe mekanizma përkatës dhe efektivë për të përcaktuar dhe adresuar raste të mospërputhjes me dispozitat e këtij Protokolli, duke përfshirë përmes zhvillimit të një liste treguese të pasojave, duke marrë parasysh shkakun, tipin, shkallën dhe frekuencën e mospërputhjes. Çdo procedurë dhe mekanizëm sipas këtij neni, që sjell pasoja të detyrueshme, do të miratohet nëpërmjet ndryshimit të këtij Protokolli.

Neni 19

Dispozitat e nenit 14 të Konventës mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të zbatohen *mutatis mutandis* të këtij Protokolli.

Neni 20

1. Çdo palë mund të propozojë ndryshime të këtij Protokolli.

2. Ndryshimet e këtij Protokolli do të miratohen në një sesion të zakonshëm të Konferencës së Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli. Teksti i çdo ndryshimi të propozuar të këtij Protokolli do t'u komunikohet palëve nga sekretariati të paktën gjashtë muaj përpara mbledhjes, në të cilën është propozuar për miratim. Sekretariati gjithashtu do të komunikojë tekstin e çdo ndryshimi të propozuar palëve dhe nënshkruesve të Konventës dhe për njoftim depozituesit.

3. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshje mbi çdo ndryshim të propozuar të këtij Protokolli me konsensus. Nëse të gjitha përpjekjet për konsensus janë ezauruar dhe nuk është arritur asnjë marrëveshje, ndryshimi si opsion i fundit do të miratohet me tri të katërtat e votave të palëve prezente dhe votuese në mbledhje. Ndryshimi i miratuar do t'i komunikohet nga sekretariati depozituesit, i cili do ta qarkullojë atë te të gjitha palët për pranimin e tyre.

4. Instrumentet e pranimit në lidhje me një ndryshim do të depozitohen te depozituesi. Një ndryshim i miratuar në përputhje me paragrafin 3 më sipër do të hyjë në fuqi për ato palë që e kanë pranuar atë në ditën e nëntëdhjetë pas datës së marrjes nga depozituesi të një instrumenti të pranimit nga të paktën tri të katërtat e palëve të këtij Protokolli.

5. Ndryshimi do të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën ajo palë depoziton te depozituesi instrumentet e saj të pranimit të ndryshimit në fjalë.

Neni 21

1. Anekset e këtij Protokolli do të përbëjnë një pjesë integrale dhe, përveç se kur shprehimisht parashikohet ndryshe, një referencë e këtij Protokolli përbën në të njëjtën kohë një referencë të çdo aneksi. Çdo aneks i miratuar pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli do të kufizohet në listat, format dhe çdo material tjetër i një natyre shpjeguese me karakter shkencor, teknik, procedural apo administrativ.

2. Çdo palë mund të bëjë propozime për një aneks të këtij Protokolli dhe mund të propozojë ndryshime të anekseve të këtij Protokolli.

3. Anekset e këtij Protokolli dhe ndryshimet e anekseve të këtij Protokolli do të miratohen në një sesion të zakonshëm të Konferencës së Palëve që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli. Teksti i çdo aneksi apo ndryshimi të një aneksi të propozuar do t'u komunikohet palëve nga sekretariati të paktën gjashtë muaj përpara mbledhjes në të cilën ai propozohet për miratim. Sekretariati gjithashtu do t'u komunikojë tekstin e çdo aneksi apo ndryshimi të një aneksi të propozuar palëve dhe nënshkruesve të Konventës dhe, për njoftim, depozituesit.

4. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshje për çdo aneks apo ndryshim të një aneksi me konsensus. Nëse të gjitha përpjekjet për konsensus janë ezauruar dhe nuk është arritur asnjë marrëveshje, aneksi apo ndryshimi i një aneksi si opsion i fundit do të miratohet me tre të katërtat e

votave të palëve prezente dhe votuese në mbledhje. Aneksi apo ndryshimi i një aneksi të miratuar do t'i komunikohet nga sekretariati depozituesit, i cili do ta qarkullojë atë te të gjitha palët për pranimin e tyre.

5. Një aneks apo ndryshim i një aneksi, përveç aneksit A apo B, që ka qenë miratuar në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të mësipërm, do të hyjë në fuqi për të gjitha palët e këtij Protokolli gjashtë muaj pas datës së komunikimit nga depozituesi këtyre palëve për miratimin e aneksit apo miratimin e ndryshimit të aneksit, përveçse për ato palë që kanë njoftuar me shkrim depozituesin, brenda asaj periudhe për mospranimin e tyre të aneksit apo ndryshimit të aneksit. Aneksi apo ndryshimi i një aneksi do të hyjë në fuqi për palët të cilat tërheqin njoftimin e tyre për mospranim ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën tërheqja e këtij njoftimi është marrë nga depozituesi.

6. Nëse miratimi i një aneksi apo ndryshimi i një aneksi përfshin një ndryshim të këtij Protokolli, ai aneks apo ndryshim i një aneksi nuk do të hyjë në fuqi për aq kohë sa ndryshimi i këtij Protokolli hyn në fuqi.

7. Ndryshimet për anekset A dhe B të këtij Protokolli do të miratohen dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e vendosur në nenin 20, duke parashikuar se çdo ndryshim i aneksit B do të miratohet vetëm me miratimin e shkruar të palës përkatëse.

Neni 22

1. Çdo palë do të ketë një votë, përjashtuar rastet kur parashikohet në paragrafin 2 më poshtë.

2. Organizatat rajonale ekonomike të integruara, në çështjet brenda kompetencave të tyre, do të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës me një numër votash të barabarta me numrin e shteteve anëtare të tyre që janë palë në këtë Protokoll. Një organizatë e tillë nuk do të ushtrojë të drejtën e saj të votës në qoftë se ndonjë nga shtetet anëtare të saj ushtron të drejtën e tij dhe anasjelltas.

Neni 23

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë depozituesi i këtij Protokolli.

Neni 24

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim dhe subjekt për ratifikim, pranim apo miratim nga shtete dhe organizata rajonale ekonomike të integruara të cilat janë palë në Konventë. Ai do të jetë i hapur për nënshkrim në Qendrën e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork nga 16 marsi 1998 deri më 15 mars 1999. Ky Protokoll do të jetë i hapur për aderim nga dita pas datës në të cilën ai është i mbyllur për nënshkrim. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit do të depozitohen me depozituesin.

2. Çdo organizatë rajonale ekonomike e integruar e cila bëhet palë e këtij Protokolli pa qenë një nga shtetet anëtare të saj palë, do të jetë përgjegjëse ndaj të gjitha detyrimeve të këtij Protokolli. Në rastin e këtyre organizatave, njëri apo më shumë shtete anëtare të të cilave është palë e këtij Protokolli, organizata dhe shtetet anëtare të saj do të vendosin në përgjegjësitë e tyre përkatëse për zbatimin e detyrimeve të tyre sipas këtij Protokolli. Në këto raste, organizata dhe shtetet anëtare nuk do të kenë të drejtën të ushtrojnë të drejtat sipas këtij Protokolli njëkohësisht.

3. Në instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, organizatat rajonale ekonomike të integruara do të deklarojnë shkallën e kompetencës së tyre në lidhje me çështjet e trajtuara nga ky Protokoll. Këto organizata do të njoftojnë gjithashtu depozituesin, i cili në kthim do të njoftojë palët për çdo ndryshim thelbësor në shkallën e kompetencës së tyre.

Neni 25

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën jo më pak se 55 palë të Konventës, përfshirë palët e aneksit I, të cilat përbëjnë në total të paktën 55 për qind të lëshimeve totale të dioksidit të karbonit për vitin 1990 të palëve të përfshira në aneksin I, kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

2. Për qëllimet e këtij neni, "emetimet e përgjithshme të dioksidit të karbonit për vitin 1990 të

palëve të përfshira në aneksin I” do të thotë sasia e komunikuar në apo përpara datës së miratimit të këtij Protokolli nga palët e përfshira në aneksin I në komunikimet e tyre të para kombëtare të paraqitura në përputhje me nenin 12 të Konventës.

3. Për çdo shtet apo organizatë rajonale ekonomike të integruar që ratifikon, pranon apo miraton këtë Protokoll, apo aderon pasi kushtet e vendosura në paragrafin 1 më sipër për hyrjen në fuqi janë plotësuar, ky Protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

4. Për qëllimet e këtij neni, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale ekonomike e integruar nuk do të numërohet si shtesë të atyre të depozituara nga shtetet anëtare të organizatës.

Neni 26

Asnjë rezervë nuk mund t’i bëhet këtij Protokolli.

Neni 27

1. Në çdo kohë pas tre vjetësh nga data në të cilën ky Protokoll ka hyrë në fuqi për një palë, ajo palë mund të tërhiqet nga ky Protokoll duke i dhënë njoftim me shkrim depozituesit.

2. Çdo tërheqje e tillë do të ketë efekt pasi të kalojë një vit nga data e marrjes nga depozituesi të njoftimit të tërheqjes, apo në një datë të mëvonshme që mund të specifikohet në njoftimin e tërheqjes.

3. Çdo Palë që tërhiqet nga Konventa do të konsiderohet gjithashtu që është tërhequr edhe nga ky Protokoll.

Neni 28

Origjinali i këtij Protokolli, tekstet në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle të cilat janë autentikisht të njëjta, do t’i depozitohen Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Kioto, më 11 dhjetor 1997.

Si dëshmi, të poshtëshënuarit, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Protokoll në datën e caktuar.

ANEKSI A

Gaze të serrave
Dioksid karboni (CO2)
Metan (CH4)
Oksid azoti (N2O)
Hidrofluorokarbonet (HFCs)
Perfluorokarbon (PFCs)
Hekzafluorid Sulfuri (SF6)
Kategori sektorësh/burimi
Energji
Djegie karburanti
Industri energjie
Industri përpunimi dhe ndërtimi
Transport
Sektorë të tjerë
Të tjera
Lëshime gazi nga karburanti
Karburante të ngurta

Naftë dhe gaz natyror
Të tjera
Procese industriale
Prodhime minerale
Industri kimike
Prodhim metali
Prodhim tjetër
Prodhim të halokarboneve dhe hekzafluorid sulfuri
Konsumi i halokarboneve dhe hekzafluorid sulfuri
Të tjera
Përdorim i solvenit dhe prodhim tjetër
Bujqësi
Fermentim i brendshëm
Menaxhim i plehrave organike
Kultivim orizi
Toka bujqësore
Djegie përshkruese e savanave
Djegie në fushë e mbetjeve bujqësore
Të tjera
Mbetje
Asgjësimi i mbetjeve të ngurta mbi tokë
Trajtimi i mbetjeve ujore
Djegia e mbetjeve
Të tjera

ANEKSI B
KUFIZIMI I EMETIMIT SASIOR OSE ANGAZHIMIT REDUKTUES TË PALËS

(PËRQINDJA E VITIT APO PERIUDHËS BAZË)

Australia	108
Austria	92
Belgjika	92
Bullgaria*	92
Kanada	94
Kroacia*	95
Republika Çeke*	92
Danimarka	92
Estonia*	92
Komuniteti Europian	92
Finlanda	92
Franca	92
Gjermania	92
Greqia	92
Hungaria*	94
Islanda	110
Irlanda	92
Italia	92
Japonia	94
Letonia*	92
Lihtenshtein	92
Lituania*	92
Luksemburgu	92

Monako	92
Holanda	92
Zelanda e Re	100
Norvegjia	101
Polonia*	94
Portugalia	92
Rumania*	92
Federata Ruse*	100
Sllovakia*	92
Sllovenia*	92
Spanja	92
Suedia	92
Zvicra	92
Ukraina*	100
Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut	92
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	93

* Shtetet që janë duke kaluar procesin drejt ekonomisë së tregut.